

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Sylja, në lëndën penale kundër të pandehurit K. C.për shkak të veprës penale, Mashtrimi nga neni 335 paragrafi 6 të KPRK-së, të cilin sipas detyrës zyrtare e ka mbrojtur av.S. M., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.916/2013 të datës 20.05.2013, të cilin e përfaqësonte Prokurorja e shtetit, Huma Jetishi, pas mbajtjes së seances dëgjimore, më 04.10.2017, shpalli publikisht, ndërsa më 09.10.2017, hartoi këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri K. C.nga babai B. dhe nëna, S. e lindur M., i lindur më ..., në Gj., me vendbanim në fsh.LI., K.Gj., ka të kryer ..., .. punësuar, shfrytëzues i ndihmës sociale, i martuar, babë i ... fëmije, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar për vepër penale, si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale kundër tij,

Ë s h t ë f a j t o r

S e p s e, me dt.2013, rreth orës ... minuta, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, me veturën e tij, të markës ..., ka shkuar te pompa e benzinës "...", e cila gjendet në rrugën e K., është furnizuar me derivate –me plinë, në vlerë prej ..., dhe është larguar nga pompa e benzinës pa e kryer pagesën, duke i premtuar punëtorit të pompës, M. L., po shkoj deri në bankë me i tërhequr të hollat dhe ti paguaj, mirëpo i pandehuri, gjer më sot, dt. ..2013, nuk është lajmëruar fare dhe nuk e ka kryer pagesën prej 15 euro.

Me çka ka kryer veprën penale, **Mashtrimi nga neni 335 paragrafi 6 i KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve:4,7, 41,42,49, 73, 74, 75,dhe 76 të KPRK-së si dhe nenit 233 dhe 365 të KPPK-së, të pandehurit, i shqiptohet :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit K. C., i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditëve, i cili denim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës verifikuese prej një (1) viti, duke filluar nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

I pandehuri detyrohet që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro, dhe 30 (tridhjetë) euro, në emër të taksës për kompenzimin e viktimave të krimit, gjithësej pesëdhjetë (50) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës se prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

I dëmtuari M. L., për kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Prokuroria Themelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën. PP.II.nr.916/2013 të datës 20.05.2013, për të pandehurin Kenan Cani, për shkak të veprës penale, mashtrimi nga neni 335 paragrafi 6 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan me 27.09.2017 ka arritur marrëveshjen për pranim të fajësisë, të nënshkruar nga Prokurori i shtetit, i pandehuri K. C., dhe mbrojtësja e tij, av. S. M..

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë prezentuar Prokurorja e Shtetit, Huma Jetishi, i pandehuri K. C., dhe mbrojtësja e tij, av.S. M..

Prokurori i shtetit ka deklaruar se mbes në tërsi pranë marrëveshjes për pranim të fajësisë, të datës 27.09.2017, nga se janë plotësuar kushtet ligjore në pajtim me nenin 233 të KPPRK-së, andaj kemi arritur marrëveshje me të pandehurin K. C.për shkak të veprës penale, mashtrimi nga neni 335 paragrafi 6 të KPRK-së, me të cilin rast i njëjti është pajtuar që të pranojë fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, edhe atë gjithnjë, në pjesëmarrje dhe konsultim me mbrojtësen e tij.

Mbrojtësja e të pandehurit K. C., av.S. M. deklaroi: siç theksoi edhe prokurorja e shtetit, pas konsultimeve të bëra me të mbrojturin tim K. C.me 27.09.2017, pranë Prokurorisë Themelore në Gjilan, kemi arritur marrëveshjen për pranim të fajësisë, në lidhje me veprën penale, mashtrimi nga neni 335 paragrafi 6 të KPRK-së, në mënyrë që i mbrojturi im të përfiton të gjitha benifitet që janë të përcaktuara në dispozitat ligjore.

I pandehuri K. C.deklaroi: në tërësi e mbështes deklaratën e mbrojtësës time.

Pas dëgjimit të palëve, gjykata në mbështetje të nenit 233 paragrafi 21 të KPPK-së, konstatoi se janë plotësuar kushtet e parapara me ligj, andaj vendosi që të pranohet marrëveshja për pranim të fajësisë, lidhur mes PTH-së – DP, në një tërësi dhe të pandehurit K. C.me mbrojtësëni e tij, av.S. M. në anën tjetër për kryerjen e veprës penale, konform dispozitivit të aktakuzës PP.II.nr.916/2013 të datës 20.05.2013.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve dhe në bazë të nenit 233 paragrafi 21, fjalja e dytë të KPPK-së, po ashtu vendosi që data e sotme të jetë data kur palët t'i japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin.

Prokurorja e shtetit Huma Jetishi deklaroi: duke marrë parasysh se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas kodit 233 për arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, kërkoj nga gjykata që të pandehurin e sipërtheksuar t'a shpall fajtor për veprën penale të cilën i'a vë në barrë aktakuza, dhe në pajtim me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, të njëjtit t'i shqiptojë sanksionin penal të paraparë në këtë marrëveshje.

Mbrojtësja e të pandehurit K. C., av. S. M. deklaroi: me që jemi dakorduar edhe në marrëveshjen për pranimin e fajësisë lidhur me dënimin, i propozoj gjykatës që të njëjtin dënim t'ia shqiptoi të pandehurit K. C., po ashtu i propozoj gjykatës që të pandehurin mos ta ngarkoj me taksa për viktimat e krimit si dhe taksat për paushall gjyqësor nga fakti se është shfrytëzues i ndihmës sociale.

I pandehuri K. C., ka deklaruar: e mbështes deklaratën e mbrojtësës time, pendohem për veprën e kryer, i kërkoj falje të dëmtuarit, me që jam i papunësuar dhe shfrytëzues i ndihmës sociale, kërkoj nga gjykata që mbrenda mundësive ligjore të më liroj nga taksa për kompenzimin e viktimave të krimit si dhe nga paushalli gjyqësor dhe

se mbrenda një afati sa më të shkurtër do ta sjell dëshmin se ende jam shfrytëzues i ndihmës sociale.

Pas pranimit të marrëveshjes të pranimit të fajësisë për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv me numër dhe datë të shënuar si më lartë, si dhe deklaratave të palëve lidhur me dënimin, gjykata të pandehurin K. C., e shpalli fajtor dhe në pajtim me nenin 233 paragrafi 21 i shqiptojë dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me dënimin e shqiptuar të pandehurit, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të pandehurin do ta parandaloj që të ardhmen mos të kryej vepra tjera penale dhe se ky dënim edhe për qytetarët e tjerë, do të ketë efekt preventues nga kryerja e veprave të ngjajshme penale .

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, në lidhje me nenin 450 paragrafi 1 nënparagrafi 2.6 të KPPK-së, ndërsa për taksën në emër të kompensimit të viktimave të krimit, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 39 paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, nr.05/L-036.

I dëmtuari Muhamet Lakna, konform nenit 463 të KPPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore Gjilan, - Departamenti i përgjithshëm
P.nr. 799/37, më 09.10.2017

Sekretarja juridike
Rafete Syla, d.V.

G j y q t a r i
Islam Thaçi ,d.V.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.